



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 26441 prot.

Shkodër, më 29.12. 2025

VENDIM

Nr. 85, datë 29.12.2025

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E NDUE RRETHAJ, LULZIM SELJA, MEJREME
SAMINI, ZAMIR SYLIA, BANESA E TË CILEVE ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; VKB nr. 33, datë 29.05.2025, “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025”, e miratuar me VKB-në nr. 76, datë 19.12.2024, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Ndue Rrethaj** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Ndue Rrethaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 921 927 (nëntëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 467 052 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e dy) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Ndue Rrethaj**.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Lulzim Selja** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.

4. Për familjen e **Lulzim Selja** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 364 322 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e dy) lekë dhe për dëmet në orendi prej 421 040 (katërqind e njëzet e një mijë e dyzet)lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Lulzim Selja**.
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Mejreme Samini** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
6. Për familjen e **Mejreme Samini** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 332 351 (treqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë dhe për dëmet në orendi prej 208 156 (dyqind e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Mejreme Samini**.
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Zamir Sylia** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Zamir Sylia** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 1 725 262 (një milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë dhe për dëmet në orendi prej 284 656 (dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Zamir Sylia**.
9. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin **AB141** “ Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025 të miratuar me VKB Nr 76 datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, në programin **AB141, Q2 O1 A4** “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 380 000 (treqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
10. Për familjen e **Ndue Rrethaj, Lulzim Selja, Mejreme Samini, Zamir Sylia** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile, “VKB Nr 33 datë 29.05.2025 Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar ,sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **1 671 932** (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën **690 452** (gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekë.
11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 26 vota

Vota Pro	26
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	1
Zbardhur me datë	29.12.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

